

VENDIM
Nr.9, datë 2.2.2007

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE PËR MASËN E
FINANCIMIT, KRITERET PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË
PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR PUNËKËRKUESIT E PAPUNË, QË KANË
MBARUAR ARSIMIN E LARTË BRENDA APO JASHTË VENDIT**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- z.Genc Ruli	Kryetar
- znj.Mimoza Dhëmbi	Anëtare
- znj.Mimoza Vokshi	Anëtare
- z.Viktor Gumi	Anëtar
- z.Ledi Bianku	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.2.2007, shqyrtoi raportin “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda dhe jashtë vendit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me shkresën nr.2495, datë 12.12.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.2, datë 13.12.2006.

Baza ligjore: Si bazë për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda dhe jashtë vendit, është neni 9 pika 2 e ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar me ligjin nr.9570, datë 3.7.2006.

Objekti/at: Objekti kryesor i ndihmës është përgatitja e fuqisë punëtore, në veçanti të rinjve, nëpërmjet programeve aktive, të cilat do të ndikojnë në zgjidhjen e problemit të papunësisë dhe rritjen profesionale të tyre.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Ndihma për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit, synon të jepet:

a) në formën e financimit të drejtpërdrejtë, për çdo punëkërkues të papunë, në masën e nivelit bazë të pagesës së papunësisë, në vlerën 5240 lekë/muaj, për një periudhë deri më 6 muaj, dhe

b) për punëdhënësit privatë, në masën e nivelit bazë të papunësisë, sipas numrit të praktikantëve çdo muaj.

2. Për komponentin e parë, janë përcaktuar drejt dhe pa diskriminimin kategoritë e punëkërkuesve që mund të përfitojnë nga skema.

3. Përsa i takon mbështetjes së punëmarrësve, skema përfshin ndërmarrjet që, në kuptimin e legjislacionit të ndihmës shtetërore, janë kryesisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Ato do të përfitojnë një vlerë prej 5240 lekë/muaj, që llogaritet si niveli minimal i pagës, plus sigurimet shoqërore të punës për çdo të trajnuar. Ato nuk do ta përfitojnë këtë vlerë monetare dhe asnjë lloj tjetër përfitimi nëse nuk vendosin një kujdestar që të përgjigjet për menaxhimin e procesit të trajnimit të përgjithshëm të kësaj kategorie punëkërkuesish.

4. Madhësia e intensitetit të ndihmës për ndërmarrjet që përfitojnë nga skema nuk i kalon 35%, që është më i ulët se intensiteti maksimal i lejuar në dispozitat e legjislacionit të ndihmës shtetërore.

5. Skema është në kuadrin e një strategjie për punësimin, me qëllim që t’i japë shtysë

këtij objektivi për disa kategori punonjësish, të tillë si: të sapodiplomuarit, apo punonjësit e rinj sezonalë, të cilët kanë vështirësi për të hyrë në tregun e punës. Për këtë arsye ka shkak të përligjur që autoritetet publike të zbatojnë masa, të cilat sigurojnë stimuj si për punëkërkuessit për rritjen e nivelit të kualifikimit të tyre, ashtu edhe për ndërmarrjet, për të rritur nivelin e tyre të punësimit, veçanërisht të punonjësve nga kategoritë e mësipërme.

6. Skema është në përputhje me kërkesat e legjislacionit evropian për ndihmën shtetërore për nxitjen e punësimit dhe ndihmën shtetërore për trajnim të punëkërkuessve në vështirësi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 7 shkronja “a”, nenin 11 shkronja “b”, nenin 13 shkronja “ç”, nenin 21 dhe nenin 32, pika 1, të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin për dhënien e ndihmës shtetërore në formën e skemës së përcaktuar në pikën 7 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.837, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuessit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”. MPÇSSHB të raportojë deri më 31 mars të çdo viti pranë DNSH, për ndihmën e dhënë nga zbatimi i kësaj skeme gjatëvitit paraardhës financiar.

2. Pika 9 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006, lidhur me mbështetjen e drejtpërdrejtë të punëkërkuessve të papunë, përbën një skemë ndihme të lejueshme. MPÇSSHB, të raportojë deri më 31 mars të çdo viti pranë DNSH, për ndihmën e dhënë nga zbatimi i kësaj skeme gjatë vitit paraardhës financiar.

3. MPÇSSHB të mbajë në një regjistër të veçantë të gjitha të dhënat për aplikimet individuale në kuadër të skemave dhe t’i ruajë ato për një periudhë 10-vjeçare, që llogaritet nga data në të cilën është dhënë ndihma e fundit individuale në secilën prej skemave.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli